



Qëndrueshmëria e Basenit Vjosë: Një guidë gjithëpërfshirëse në menaxhimin e burimeve ujore

Një udhëzues gjithëpërfshirës për menaxhimin efektiv të burimeve ujore në basenin e Vjosës. Broshura mbulon shtatë tema kryesore, specifikiisht *përmbytjet dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet, ndryshimet klimatike, furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza, ekoturizmin, zonat e mbrojtura, burimet natyrore dhe hidroenergjinë*. Gjithashtu, për secilën tematikë, ofrohet një pasqyrë e përgjithshme, aspekte mbi kuadrin ligjor, një analizë e kontekstit dhe rekomandime në adresimin e sfidave kryesore. Informacioni i ofruar synon të mbështesë aktorët kyç për një vendimmarrje efektive lidhur me qeverisjen e ujit në Basenin Vjosë.

Nëntor 2023

© Foto nga Rajmond Kola


Implementuar nga:

EURONATUR



Me financim nga:

 Austrian
Development
Agency



www.ecoalbania.org
www.euronatur.org

Përmbajtja

	Përmbytjet dhe menaxhimi i riskut nga përmbytjet	2
	Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura	9
	Hydroenergji	14
	Menaxhimi i burimeve natyrore	19
	Zonat e mbrojtura	24
	Ekoturizmi	29
	Ndryshimet klimatike	34



Përmbytjet dhe menaxhimi i riskut nga përmbytjet

Ekspert: Assoc. Prof. Klodian Skrame, Ph.D

Përshkrim i përgjithshëm

Përmbytjet janë një fenomen shumë i shpeshtë në basenin e lumit Vjosa (në vijim BUV). Lumi Vjosa karakterizohet nga përmbytje të mëdha të cilat kanë vlera të prurjeve nga 2000-3000 m³s⁻¹ në pjesën e sipërme deri në 5000-6000 m³s⁻¹ në rrjedhën e poshtme¹. Duke iu referuar burimeve arkivore, përmbytje të mëdha në BUV janë vërejtur edhe në të kaluarën.

Sipas të dhënave të disponueshme, janë regjistruar 11 përmbytje të mëdha ku secila prej tyre ka shkaktuar dëme të konsiderueshme të pronës private. Disa nga më të rëndësishmet janë përmbytjet e viteve 1860, 1865, 1867, 1868, 1869, 1870 dhe 1871. Megjithatë, përmbytjet më të mëdha dhe katastrofike kanë ndodhur në vitet: 1971, 1980, 1997, 2015, 2017 dhe e fundit në janar 2021 ku zona afër grykëderdhjes ka qëndruar e përmbytur për disa ditë. Këto përmbytje ishin ato më shkatërrueset duke shkaktuar mbytjen e shumë bagëtive, përmbytjen e mijëra ndërtesave dhe dëmtimin e qindra aktiviteteve të biznesit, duke mbuluar të gjithë lagunat dhe të korrat e fushave afër zonës së grykëderdhjes së lumit.

Gjatë përmbytjeve të 31 Dhjetor-01 Janar të vitit 1971 lumi Vjosa doli nga shtrati duke përmbytur fshatrat Mifol dhe Novoselë. Reshjet intensive të shiut shkaktuan shumë rrëshqitje dherash. Në lagunën bregdetare të Nartës, sasi të mëdha uji depërtuan, duke shkaktuar ndryshime të mëdha në regjimin e kripës, oksigjenit dhe sedimenteve.

Një tjetër përmbytje shkatërruese e lumit Vjosa ishte ajo e shkurtit 2015. Për shkak të reshjeve intensive (mbi 150 mm/24 orë) shumë komuna dhe fshatra u përmbytën në BUV. Lumi Vjosa doli nga shtrati duke përmbytur pothuajse të gjithë zonën në rrjedhën e poshtme dhe duke shkaktuar dëmtimin e 1700 ndërtesave (pjesa më e madhe e të cilave në afërsi të lumit), 16 shkollave dhe 10 urave. Rreth 300 biznese u shkatërruan, shumë bagëti, qindra familje të evakuara dhe rreth 13,000 ha toka të përmbytura (pjesa më e madhe toka bujqësore).

1) 1 m³s⁻¹ - Metër kub në sekondë

Sipas pjerrësisë dhe karakteristikave të përmbytjeve, pothuajse të gjitha “përmbytjet e Vjosës” mund të etiketohen si “përmbytje të shpejta” ose siç njihet në literaturë me termin “flash floods”. “Flash floods” mund të kenë origjinë të ndryshme, por janë të lidhura kryesisht me reshjet ekstreme të shiut që vijnë nga stuhitë. Intensiteti i reshjeve, vendndodhja dhe shpërndarja e tyre, topografia, llojet dhe dendësia e vegjetacionit, përdorimi, përbërja dhe lagështia e tokës, së bashku, ndikojnë në shpejtësinë me të cilën mund të ndodhin përmbytjet e shpejta dhe zonat që do të preken.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm hidrologjik është fakti se “flash floods” nuk zbuten apo dobësohen ndërsa lëvizin në drejtim të rrjedhës, madje mund të ndodh e kundërta e të bëhen edhe më të forta. Për më tepër, “flash floods” ndodhin aq shpejtë sa njerëzit shpesh e gjejnë veten të papërgatitur. Në disa raste, uji mund të rritet me shpejtësi, duke bllokuar njerëzit ose duke shkaktuar dëme në prona, pa u dhënë kohën e mjaftueshme për të marrë masat e duhura mbrojtëse. Në BUV “flash floods” ndikohen negativisht nga faktorë të tillë si ndryshimi i klimës, degradimi i mjedisit dhe urbanizimit në rritje.

Veç kësaj, vlen të përmendet se ndërhyrjet e njeriut, të tilla si praktikrat e këqija në menaxhimin e lumit dhe nxjerrja e pakontrolluar e sedimenteve nga shtrati i lumit, kanë patur dhe vazhdojnë të kenë një efekt negativ në morfologjinë e shtratit të lumit Vjosa dhe degëve të tij.

Politikat dhe kuadri ligjor

Kuadri ligjor mbi përmbytjet dhe menxhimin e riskut nga përmbytjet mbështetet në:

- a) VKM nr. 835, datë 3 dhjetor 2004 – Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
- b) Ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”
- c) Draft strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF 2023–2030)

Sipas SKZRF institucionet përgjegjëse për menaxhimin e riskut nga përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave janë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e mbështetur nga bashkitë përkatëse, institucionet e Prefektit të Qarkut, si dhe Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). IGJEO është aktori kryesor që zbulon, monitoron, analizon, parashikon, shpërndan dhe komunikon në kohë informacionin paralajmërues për përmbytjet e mundshme.

Për të forcuar dhe rritur nivelin e menaxhimit të riskut nga përmbytjet, Shqipëria po harton dokumentin e Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve të përbërë nga 3 komponentë:

- 1 Vlerësimin Paraprak të Riskut nga përmbytjet që çon në identifikimin e zonave ku ekziston risku i mundshëm i përmbytjeve ose ka të ngjarë të ndodhin përmbytje;
- 2 Hartat e rrezikut dhe hartat e riskut nga përmbytjet;
- 3 Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet.

Objektivat kryesore për mbrojtjen nga përmbytjet që duhen arritur brenda një periudhe 9-vjeçare sipas autorëve të SKZRF 2023-2030 janë:

- 1 Zvogëlimi i dëmeve nga përmbytjet dhe dëmeve në më pak se 50% të asaj që ka ndodhur vitet e fundit.
- 2 Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së dëmtuar dhe ku ka risk shembjeje.
- 3 Ndërtimi i strukturave të reja mbrojtëse aty ku është e nevojshme.
- 4 Trajnimi i personelit të institucioneve përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në drejtim të monitorimit, projektimit, ndërtimit dhe riparimit të infrastrukturës mbrojtëse.
- 5 Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së forcave operacionale ndaj përmbytjeve.

SKZRF 2023-2030 parashikon disa Projekte Strategjike për sa i përket atyre të lidhura me përmbytjet, paralajmërimet e hershme, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave, një pjesë e mirë e të cilave planifikohen edhe në Basenin Ujor Vjosë.

Analiza e kontekstit

Fatkeqësisht, më shumë se gjysma e popullsisë shqiptare jeton shumë afër zonave të grykëderdhjes së lumenjve, ku rreziku nga përmbytjet është shumë i lartë. Bazuar në analizat më të fundit, është evidente se shumë zona përgjatë lumit Vjosa përballen me rreziqe të konsiderueshme përmbytjesh. Figurat 1, 2, 3 dhe 4 ilustrojnë zonat më të cënueshme brenda bashkive Përmet, Gjirokastrë, Vlorë dhe Tepelenë².

Figura 1

Zonat e rrezikuara nga përmbytjet në Bashkinë Përmet: 1. Ura e Grykabardhës – Lumi i Dëshnicës, 2. Rezervuari i Varibotit – Lumi Shtika, 3. Rezervuari i Pacomit, 4. Fshati Kosinë, 5. Pasarella e Buallit, 6. Parku i Autobusëve të Përmetit 7. Bredhi i Badlonjës, 8. Langaricë, 9. Ura e Draçovës dhe 10. Çarshova.

Figura 2

Zonat e rrezikuara nga përmbytjet në Bashkinë Gjirokastrë: 1. Ura e Kardhiqit, 2. Virua, 3. Kthesa e Aznakut 4. Ura e lumit, 5. Përroi i Cullës, 6. Varrezat, 7. Kordhoca dhe 8. Dropull i Poshtëm.

Figura 3

Zonat e rrezikuara nga përmbytjet në Bashkinë Vlorë: Seksioni Selenicë – Deti Adriatik: 1. Delta, 2. Dëllënje, 3. Zhukë, 4. Pishë Poro, 5. Bishan, 6. Fitore, 7. Novoselë, 8. Mifol dhe 9. Bashkia Selenicë.

Gryka e lumit, pjesa ku lumi Vjosa takohet me detin Adriatik, ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje për të mundësuar komunikimin e lumit me detin. Në këtë mënyrë do të reduktohet rreziku i përmbytjeve në këtë sektor.

Figura 4

Zonat e rrezikuara nga përmbytjet në Bashkinë Tepelenë: Gurëz dhe Ura e Leklit.

2) Të dhënat konsistojnë në vëzhgime të ekspertit dhe informacioni i mbledhur gjatë seminareve të zhvilluara me komunitetin në kuadër të projektit Espid4Vjosa, 2023.

Legjenda

■ Digat e medha, 2021

Ligatinë



Rrjedhë ujore

- Përrua
- kanal
- Lumë
- Liqen
- Rezervuar

Rrjeti i rrjedhës ujore

- Përrua
- Kanal

Rendi 3 (Kufi Bashki)



Rendi 2 (Kufi Qarku)




Zonat e rrezikuara nga përmbytjet



Fig. 1



Fig. 2



Legjenda

■ Digat e medha, 2021

Ligatinë



Rrjedhë ujore

- Përrua
- kanal
- Lumë
- Liqen
- Rezervuar

Rrjeti i rrjedhës ujore

- Përrua
- Kanal

Rendi 3 (Kufi Bashki)



Rendi 2 (Kufi Qarku)



Zonat e rrezikuara nga përmbytjet



Fig. 3




Fig. 4



Zgjidhjet e propozuara

1

Instalimi i stacioneve hidro-meteorologjike dixhitale të aksesueshme nga të gjithë institucionet dhe rritja e kapaciteteve teknike dhe operacionale. Referuar SKZRF 2023-2030 ekziston nevoja për modernizim dhe rehabilitim të rrjetit të stacioneve të motit, mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve, lidhje të rregullta të besueshme në internet, staf të ri të kualifikuar, si hidrologë dhe meteorologë dhe dixhitalizim të të dhënave me qëllim përmirësimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Shqipërisë. Për më tepër, sipas SKZRF 2023-2030 rezulton se kapacitetet teknike dhe operacionale të institucioneve shqiptare për parashikimin, monitorimin dhe paralajmërimin e të dhënave hidro-meteorologjike konsiderohen ende të pamjaftueshme. Instalimi i stacioneve hidro-meteorologjike dixhitale do të ndihmojë jo vetëm në menaxhimin e përmbytjeve dhe parandalimin e dëmeve nga ana e tyre, por do të ndihmojë edhe në njohjen e sasisë së ujit që kalon në BUV.

Ndryshimet klimatike do të sjellin gjithmonë dhe më shpesh periudha të gjata thatësire të ndërthurura me periudha të shkurtra me reshje intensive. Njohja dhe menaxhimi i saktë i ujit në BUV do të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave, në planifikim dhe përdorim të kujdesshëm të tokave. Aspekti më i rëndësishëm është ndarja e të dhënave. Të gjitha të dhënat e mëparshme hidrometeorologjike, së bashku me të dhënat e reja të marra nga stacionet e reja hidrometeorologjike duhet të jenë të disponueshme për publikun pa asnjë kufizim, veçanërisht për institucionet kërkimore. Të dhënat mund të menaxhohen dhe sigurohen nga një institucion përgjegjës, si IGJEO.

2

Mirëmbajtja e kanaleve dytësore ose të treta në formë periodike, vlerësimi i qëndrueshmërisë si dhe përforcimi dhe monitorimi i digave, pritave, argjinaturave etj. Sipas SKZRF 2023-2030 rezulton se disa prej argjinaturave kanë nevojë për riparim, rehabilitim, rindërtim, apo ridimensionim për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në dekadat e fundit.

3

Të sigurohet një menaxhim i koordinuar i shkarkimeve të ujit, kanaleve, lumenjve dhe strukturave të lidhura me ujin, menaxhim i cili ndahet mes shumë institucioneve dhe autoritetesh. Bashkërendimi dhe vendimmarrja kolegjiale në nivel lokal dhe kombëtar është thelbësor për vendosjen e standardeve të matshme për zgjidhjen e problemeve.

Për më tepër, shkëmbimi efektiv i informacionit dhe njoftimi i hershëm janë thelbësore për zbutjen dhe, në disa raste, parandalimin e përmbytjeve që vijnë nga akumulimi i ujit në nivele të larta. Shpërndarja e koordinuar e informacionit dhe zbatimi i një strategjie për informimin e publikut janë të një rëndësie të madhe për sigurinë e jetës së njerëzve dhe pronave në zonat me rrezik të lartë.

4

Për të garantuar siguri dhe zhvillim të qëndrueshëm, është thelbësore që planifikimi, përdorimi i tokës dhe veprimet e njerëzve të marrin parasysh rreziqet e mundshme të përmbytjeve. Zgjidhja e vetme afatgjatë konsiston në planifikimin e zonave urbane jashtë zonave të cilat preken nga përmbytjet. Ndërsa planifikimi i përdorimit të tokës me fokus reduktimin e rrezikut nga përmbytjet është diskutuar gjerësisht në literaturë, ka ende një mungesë të dukshme të një qasjeje të mirëpërcaktuar për planifikimin e përdorimit të tokës dhe zbutjen e përmbytjeve në Shqipëri. Kjo e fundit e kombinuar me modele të rastësishme të zhvillimit të territorit, duket se karakterizon gjithë vendin.

Një aspekt i rëndësishëm i Reduktimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë (RrF) është implementimi i planeve dhe rregulloreve sipas një qasje të bazuar në vlerësimin e riskut në përdorimin e tokës me qëllim zbutjen e shkaqeve që lidhen me katastrofat dhe dëmtimet që rezultojnë prej tyre. Ndaj dhe përfshirja e RrF në planifikimin dhe përdorimin e tokës duhet të jetë një prioritet. Gjithashtu, planifikuesit e territorit duhet të orientojnë komunitetin në ndërtimin e strukturave rezistente ndaj fatkeqësive natyrore dhe në zona të cilat nuk preken nga përmbytja.

Shpyllëzimet ngelen një problem thelbësor dhe shkaktari kryesor në rritjen e fenomenit të erozionit, sidomos në formacionet gjeologjike të brishta sikurse janë ato Flyshore, me ndërthurje të formacioneve ranore me ato argjilore. Kjo rezulton në humbjen e hektarëve të tërë toke të cilët mund të përdoren mjaft mirë për qëllime bujqësore dhe në sektorin blegtoral. Mungesa e pyjeve dhe e bimësisë në shpate, përgjatë luginës së Vjosës, bën që në rastet kur kemi reshje intensive në një kohë të shkurtër, fenomene këto të ndihmuara edhe nga ndryshimet klimatike, e gjithë sasia e madhe e ujit të arrijë në një kohë tej mase të shkurtër rrjedhën kryesore të lumit Vjosa. Ujërat sipërfaqësorë, të cilët nuk kanë hasur asnjë rezistencë në shpate, do të rrisin në mënyrë të ndjeshme sasinë e prurjeve duke krijuar përmbytje të shpeshta dhe gjithmonë dhe më të mëdha në rrjedhën e poshtme të lumit Vjosa.

5

Masat e tjera kyçe përfshijnë: përgatitjen e kurrikulave universitare për menaxhimin e baseneve lumore dhe reduktimin e rrezikut nga përmbytjet; bashkëpunimin me vendet fqinje për menaxhimin e përmbytjeve; rritjen e kapaciteteve teorike për punonjësit e administratës lokale mbi aspekte të menaxhimit të burimeve ujore dhe reduktimin e rrezikut nga përmbytjet.



Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Ekspert: Dr. Klodian Muço

Përshkrim i përgjithshëm

Ndryshimet klimatike dhe përdorimi i papërgjegjshëm i burimeve natyrore (tokë, ujë, ajër) po sjellin degradimin e mjedisit dhe territorit duke përshpejtuar procesin e ndryshimeve klimatike duke sjellë thatësira në periudhën e verës dhe përmytje gjatë stinës së dimrit. Sipas të dhënave të specialistëve, rreth 21% e pyjeve në Shqipëri janë në një shkallë të avancuar degradimi. Me pasoja të rënda në aktivizimin e erozionit është edhe braktisja e tokave të degraduara/shpyllëzuara vite më parë, sidomos në zonat malore¹. Ndotja e ujit në Shqipëri është një tjetër problematikë e shkaktuar nga hedhja e mbeturinave dhe shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara dhe atyre të ndotura. Ndotje industriale e lumenjve është vërejtur në lumenjtë Shkumbini, Fani, Gjanica dhe Semani, të cilët janë prekur nga përbërës organik toksik dhe metalet nga veprimtaria minerare dhe industriale.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve përbëhet nga një sistem i dobët grumbullimi në qytete dhe pothuajse i munguar në zonat rurale. Riciklimi bëhet nga kompani private, për mbetjet plastike, metalike, qelqi dhe letre të cilat përpunohen ose paketohen dhe më pas shiten në vende të tjera. Pjesa tjetër e mbetjeve depozitohet dhe trajtohet në landfill. Ndërgjegjësimi për riciklimin e mbetjeve është i ulët. Hedhja dhe depozitimi i mbeturinave mbetet një problem serioz për Shqipërinë.

Uji është një burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në luginën e Vjosës, ai është thelbësor për prodhimin e produkteve bujqësore dhe blektorale, është baza për rritjen e peshkut i cili është burim ushqimor për komunitetin lokal (peshkimi sportiv), ndërsa lumi në kompleks shërben për turizëm dhe rekreacion. Shfrytëzimi i mirë i ujit konsiderohet alternativa e vetme për tu ndërmarrë, për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm në dimensionin mjedisor, ekonomik e social. Po ashtu është baza për frenimin e migracionit dhe shpopullimet e zonave rurale në vend.

¹ Lireza Q., Lireza N. (2014), *The problems of land degradation in Albania. European Scientific Journal*. 10(11), 71 – 76.

Ndotja nga ujërat e zeza që derdhen në lumë, hedhja e materialeve të ngurta apo përdorimi i inerteve mund të kthehet në një kosto të rëndë për luginën duke kompromentuar shëndetin e komunitetit dhe vlerat natyrore. Duket se kjo situatë është prezente në të gjithë lumenjtë në Shqipëri (rrjedha kryesore dhe tributaret): Drin, Shkumbin, Seman, Vjosa, Erzeni etj.

Politikat dhe kuadri ligjor

Qeveria e Shqipërisë duke pasur si objektiv integrimin në BE, ka punuar për të harmonizuar legjislacionin me kuadrin ligjor të BE-së dhe synon të krijojë përgjegjësi të qarta për zbatimin e Acquis të BE. Prandaj, në fushën e cilësisë së ujit ka pasur përparim në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit.

Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura" synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar gjithashtu rregullat e trajtimit mjedisor dhe detyrimet për shkarkuesit e ndotësve.

Me aprovimin e ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i azhornuar me Ligjin Nr. 6/2018, "Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore" (AMBU) është institucioni përgjegjës për menaxhimin, sigurimin dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore si dhe për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit. Miratimi i VKM Nr. 662, datë 21.09.2016 "Për miratimin e tarifave për nxjerrjen/përdorimin e shkarkimeve ujore dhe të lëngshme" është dëshmi e progresit në fushën e administrimit kombëtar të ujërave. Nga sa më sipër mund të vërehet qartë se Shqipëria e ka një kuadër ligjor relativisht të plotë por ngelet ende sfidë pjesa e zbatimit dhe ligjshmërisë nga institucionet publike dhe private.²

Në luginën e Vjosës, bashkitë janë autoritetet që aktualisht kanë në pronësi ujësjellsat që furnizojnë me ujë të pijshëm banorët. Po bashkitë janë përgjegjëse edhe për trajtimin e ujrave të zeza dhe të ndotura. Mungesa e kapaciteteve dhe burimeve financiare për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza urbane, e bën të pamundur trajtimin e duhur të ujërave pothuajse nga të gjitha bashkitë që shtrihen përgjatë luginës së Vjosës.

2) Ligji 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i azhornuar me Ligjin nr. 6/2018; Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura.

Analiza e kontekstit

Ujërat e lumenjve sot konsiderohen një burim i rëndësishëm për zhvillimin e një sërë aktivitetesh tregtare, duke gjeneruar të ardhura dhe punësim. Shfrytëzimi i tyre duhet të jetë në përputhje me legjislacionin dhe me kritere të mirëpërcaktuara pasi shkatërrimi i rrjedhave të lumenjve apo ndotja e tyre, dëmton organizmat dhe vegjetacionin, bëhet burim shpërndarjesh bakteresh dhe virusesh që absorbohen nga peshqit dhe molusqet që janë të destinuar për konsum.

Referuar Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit 2021 (AKM, f.6) për menaxhimin e ujit ekzistojnë tre dokumente strategjike³ që kanë si qëllim primar sigurimin dhe menaxhimin e integruar dhe funksional të burimeve ujore duke vendosur kështu sisteme monitorimi dhe menaxhimi të rreziqeve nga përmbytjet dhe shterimi i burimeve ujore. Aktualisht ka 38 stacione monitorimi në lumenjtë kryesorë të vendit nga të cilët 5 të tilla janë në Basenin e lumit Vjosa⁴. Rezultatet e këtyre monitorimeve tregojnë se ujërat e lumit Vjosa kanë një cilësi të mirë⁵. Shkalla e mbulimit me kanalizime në bashkitë përgjatë luginës varion nga 1.7% deri në 66.8%. Përsa i përket aspektit ekonomik, referuar të dhënave të Instat (2022) dhe studimit të Muço (2020) rezulton se në luginën e Vjosës zhvillohen rreth 25 aktivitete tregtare të cilat e kanë ujin apo shtratin e lumit burim primar (akuakulturë, pika grumbullimi inertesh) dhe me dhjetra biznese të tjera të fokusuar në bujqësi dhe blektori dhe që janë të lidhur ngushtësisht me disponueshmërinë e ujit të lumit.

Po ashtu në luginën e Vjosës ka dhe një sërë burimesh ujore të pijshëm që përdoren nga zonat e banuara, të cilat janë në menaxhim të bashkive. Sfidat e vërtetë në përdorimin e ujit në fakt ngelet menaxhimi i ujërave që përdoren për vaditje, ku shpesh herë uji konsiderohet si pronë e askujt duke mos marrë në konsideratë aspektet e ndotjes dhe kapaciteteve të burimeve ujore. Referuar VKM Nr. 550, datë 15.07.2020 pika 2a dhe 7, autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujrave është AMBU.

3) Strategjia Kombëtare e Integruar për Burimet Ujore 2018-2027, Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017, Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe plani i veprimit identifikon pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet për ujitje, kullim, diga dhe rezervuarë dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

4) Vj1 Lumi i Vjosës; Vj2, Lumi i Vjosës ura e qytetit; Vj3 lumi drino Ura e Leklit Tepelenë; vj4 Lumi i Vjosës Ura e Memaliaj; Vj5 Lumi Vjosë Ura e Mifolit Vlorë. Raporti i gjendjes në mjedis, 2022.

5) Ujërat e lumit Vjosa janë të pasura me oksigjen duke i klasifikuar në Klasën I. Bazuar vlerave të NBO5, i cili është parametër i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, vlerësohet se stacionet klasifikohen në Klasën II- Cilësi e mirë.

Sot lumi i Vjosës kërcënohet nga veprimtari publike apo private që e shfrytëzojnë atë për hedhjen mbetjeve të ngurta, derdhjen e ujërave të zeza, shkarkimin e ujërave të ndotura nga aktivitetet e akuakulturës, si dhe për funksionimin e pikave të grumbullimit të materialeve inerte. Bashkitë si ajo e Tepelenës dhe Përmetit nuk arrijnë të ndajnë ujërat e bardha nga ato të zeza, ndërkohë që pjesa më e madhe e bashkive përgjatë lumit Vjosë, përdorin brigjet e lumit si pikë hedhjesh mbetjesh të ngurta.

Po ashtu ka një sërë biznesesh të tjera si prodhim bojrash, therrtore apo prodhim këpucësh të cilat pas shfrytëzimit të ujërave i derdhen ato përgjatë lumit Drino (degë e lumit Vjosa) pa i filtruar më parë⁶.

Efekti kumulativ i tyre përbën një kërcënim për cilësinë e burimeve ujore dhe gjallesave që jetojnë në të. Një problematikë tjetër ngelet sistemi i kanalizimeve si dhe impiantet e trajtimit të ujërave urbane, infrastruktura e të cilave në pjesën më të madhe të bashkive karakterizohen nga një infrastrukturë e munguar ose e dobët. Mbulimi me kanalizime në bashkitë që shtrihen përgjatë luginës së Vjosës është nga 1.7% në Dropull deri në 68.6% në Përmet, ndërkohë në Memaliaj 31.9%, Gjirokastër 40.3% dhe Tepelenë 48.5%.⁷

Duke qenë se lugina e Vjosës po kthehet gjithmonë e më tepër në një atraksion për turizëm, konsiderohet primare për komunitetin zgjidhja e problemit të ndotjes së ujit, të dëmtimit të shtratit të lumit si dhe rregullimi ligjor për filtrimin e ujërave që gjenerohen nga aktivitetet ekonomike ashtu siç ndodh edhe në vendet e BE-së, ku Shqipëria aspiron të anëtarësohet. Këtu përfshihet gjetja e zgjidhjeve për trajtimin e ujërave të zeza nga bashkitë Përmet, Këlcyrë, Gjirokastër dhe Tepelenë.

Zgjidhjet e propozuara

1

Sigurimi i masave që do të merren nga institucionet vendore për të zgjidhur problemin e ndarjes së ujërave të reshjeve nga ujërat e zeza për të reduktuar ndotjen e ngjashme me Asistencën Teknike për Projektin e Menaxhimit të Ujërave të Zeza në Durrës, financuar nga Western Balkans Investment Framework; Projekti i Përmirësimit të Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe i mbështetur dhe finalizuar nga Japan International Cooperation Agency në 2008.

2

Marrja e masave ligjore për aktivitetet ekonomike në mënyrë që të përdorin filtrat e depurimit. Aktualisht nuk ka një kuadër ligjor i cili detyron përdorimin e filtrave të depurimit në aktivitetet ekonomike. Legjisllacioni parashikon sanksione vetëm në rast të ndotjes së ujërave territoriale.

⁶) Verifikime të bëra nga ekspertët në terren.

⁷) AKM (2021). *Cilësia e ujërave sipërfaqësore në vendin tonë, f.50-51.*



3

Të sigurohet përdorimi i pesticideve dhe fertilizuesëve të çertifikuar nga BE, në bujqësi përgjatë luginës së Vjosës, nëse lejohet dhe nëse është në përputhje me rregullat e zonës së mbrojtur. Këto kimikate depërtojnë në tokë dhe ndotin ujërat nëntokësorë, për rrjedhojë dhe burimet ujore që konsumohen nga banorët e zonës. Pjesa më e madhe e tyre përfundojnë në lumin Vjosa, duke e ndotur atë dhe duke rrezikuar gjallesat.⁸ Aktualisht, lidhur me këtë çështje, janë marrë masa nga Programi për Zhvillimin Rural në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë 2021-2027. Objekti i programit është i gjithë territori i Shqipërisë.

4

Planifikimi i investimeve rehabilituese dhe përmirësuese në furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza duke ndaluar derdhjen e ujërave të ndotur në lumë si dhe duke i kanalizuar ato në një rrjet kanalizimesh funksionale, p.sh., nëpërmjet investimit të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri, Gjyrokastër përurorë përfundimin e punimeve për të përmirësuar performancën e ndërmarrjes së ujit dhe për të zgjeruar furnizimin me ujë të pastër (Janar 2023).

5

Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi përdorimin e përgjegjshëm të ujit duke shmangur shpërdorimin dhe ndotjen, p.sh., fushata “Mos Zgjidhni Zhdukjen” realizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe “One Telecommunications” synon të nxisë ndërgjegjësimin për efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike tek njerëzit dhe në planet.

6

Ndërhyrja për hartimin e një plani për zbatimin e masave dhe aplikimin e sanksioneve për rastet e konstatimit të ndotjes. Legjislacioni shqiptar konvergjon vazhdimisht me atë të BE-së përse i përket konservimit dhe ruajtjes së tokës. Problemi kryesor mbetet zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar.⁹ “Në nëntor 2022, ujërat e lumit Gjanica (Bashkia Fier) u ndotën nga llumi i mbetjeve të kompanive hidrokarbure dhe fabrikave të ullirit. Kjo situatë zgjati për gati 10 ditë rresht. Tre muaj pas këtij incidenti mjedisor, nuk është e qartë nëse Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) ka identifikuar kompaninë që shkaktoi ndotjen, edhe pse u ngrit një grup pune i posaçëm. Në përgjigjen e saj për Investigative Network Albania (INA), ARM thotë se nuk ka vendosur gjobë për rastin, pasi nuk ka qenë ky qëllimi i kontrollit në terren”.¹⁰ Ky rast është dokumentuar nga INA në portalin e saj, por një situatë e ngjashme vërehet edhe në shumë zona të tjera të vendit si lumenj, liqene dhe pyje.

8) Zhdukja e lundërzës së ujit është indikator i ndotjes së lumit Vjosa sipas Dekanit të Shkencave të Natyrës së Universitetit “Eqrem Çabej”, Prof. Uruçi.

9) Selimi Sh., Zaganjori Xh. (2017). Environment protection in the legal system of Albania: The current situation in Albania on combating environmental crimes and the new reform directions. Academicus – International Scientific Journal. Available at <https://academicus.edu.al/nr14/Academicus-MMXVI-14-028-041.pdf> (accessed on 29/09/2023)

10) Investigative Network Albania, <https://ina.media/?p=6831&lang=en>



Hidroenergjia

Ekspert: Dr. Ines Jaho dhe Dr. Elton Qëndro

Përshkrim i përgjithshëm


Lumi i Vjosës, i gjatë 270 km (168 milje) u shpall Park Kombëtar i kategorisë II-të, sipas IUCN më 13 Mars 2023, pas një beteje të gjatë mes Qeverisë Shqiptare, shoqërisë civile (vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare), komuniteteve lokale, medias dhe shkencës kombëtare dhe ndërkombëtare.¹ Në të vërtetë, fushata për mbrojtjen e Lumit Vjosa ishte një fushatë që nisi kundër zhvillimit të hidroenergjisë, si një nga kërcënimet thelbësore të saj. Në harkun kohor 2005–2015 një numër i madh lejesh konçesionare u lëshuan nga Qeveria Shqiptare për të ndërtuar dhe operuar hidrocentrale të vegjël në basenin e Lumit Vjosa. Megjithëse, saktësimi i lejeve koncesionare të lëshuara ka qenë gjithmonë një debat shifrash, jo vetëm në Shqipëri por dhe në Ballkan, ku 3281 diga hidrocentralesh janë planifikuar nga ku 1726 janë funksionale, 108 në ndërtim dhe 50% e tyre (1689) në zonat e mbrojtura.² Nisur nga prurjet ujore të mëdha të Lumit Vjosa³, ku shkarkimet mesatare vjetore në daljen e tij në detin Adriatik janë rreth 195 m³/s dhe prurja minimale gjatë verës është prej 33 m³/s. (Seferlis et al. 2008), qeveria shqiptare e ka vlerësuar tradicionalisht potencialin hidrik të Lumit Vjosa.

Gjithsej 59 hidrocentrale ishin planifikuar të ndërtoheshin në Pellgun Ujëmbledhës të Vjosës midis viteve 2000–2022. Megjithatë vetëm disa prej tyre janë përfunduar: janë 3 HEC-e në fazën e ndërtimit, 11 në punë dhe 45 në pritje të miratimit (MIE, 2022). HEC- et funksionale janë vendosur në degët e Vjosës, ndërsa më të dëmtuarit duket se janë lumenjtë e Çarshovës dhe Langaricës. Për këtë arsye, të dy degët nuk janë përfshirë në Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa. Shumica e pjesës tjetër të HEC-eve janë ende në fazën e hershme të planifikimit.

1) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2023)

2) Schwarz, U., 2022. *Hydropower Projects on Balkan Rivers – 2022 Update*. RiverWatch & EuroNatur, Vienna/Radolfzell, 37 pp

3) Shkarkimi mesatar vjetor i Aaos është rreth 70 m³/s i cili përfshin rrjedhën nga Dega e Sarandoporos (18 m³/s; shkarkim mesatar vjetor i lumit Drinos në Hormovë 39 m³/s dhe lumit Shushicë ka një shkarkim mesatar vjetor 19 m³/s



Përpos, planeve për HEC-e të vegjël, tematika e hidroenergjisë në Basenin e Vjosës ka qenë e rëndësishme për qeverinë e mbështetur dhe nga studime të pjesshme (Sogreah 2008/9) i cili ka vlerësuar vetëm potencialin hidroenergjetik të Vjosës përmes ndërtimit të HEC-eve me digë në rrjedhën e saj kryesore me një kapacitet prodhues prej 458 MW që do përfshinte: HEC Kaludh (54 MW), HEC Dragot (109 MW), HEC Kalivaç (92 MW), HEC Poçem (99.5 MW) dhe HEC Karbonari (68 MW). Energjia e prodhuar nga ndërtimi i këtyre HEC-eve do të ishte, sipas studimit 1810 GWh në vit dhe do të siguronte energjinë për afërsisht 276.823 familje.⁴ Planet për të ndërtuar HEC Kalivaç dhe Poçem me një kapacitet të instaluar prej 210 MW dhe një investim total prej 250 milionë Eurosh janë kundërshtuar fort nga banorët, shoqëria civile dhe figura publike kombëtare dhe ndërkombëtare në rrugë ligjore, politike, shkencore dhe nëpërmjet medias.⁵

Politikat dhe kuadri ligjor



Fshati Kutë © Foto nga Adrian Guri

Shqipëria ka hartuar strategjinë kombëtare të energjisë 2018–2030 përmes VKM nr.480 datë 31.07.2018 ku ka përcaktuar qartë zhvillimin e saj energjetik të bazuar në 5 skenarë zhvillimi dhe hidroenergjia luan sërish një rol të rëndësishëm për të arritur detyrimet prej 38% energji të rinovueshme dhe 9% efikasitet të energjisë, si detyrim i Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Për këtë qëllim, qeveria ka hartuar dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2021–2030, si detyrim i Paktit të Gjelbër (Green Deal) dhe Marrëveshjes së Parisit, të cilat janë ligjërisht të detyrueshme.

PKEK 2030 përfshin objektivat si: reduktimi i emetimeve të gazeve serë në 18,7%, reduktim i konsumit të energjisë me 8.4% dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme në masën 54.4% të kërkesës përfundimtare për energji deri në vitin 2030. Në këtë kontekst strategjik dhe politikash, qeveria ka përditësuar ligjin për sektorin energjetik 43/2015; ligjin për hidrokarburet nr.7746/1993, ligjin për zonat e mbrojtura 81/2017; ligjin për energjitë e rinovueshme 2017. Analiza e zhvillimeve të Basenit të Lumit Vjosa është parë në këndvështrimin e këtyre, politikave energjetike.

4) Ylliad (2015) Analysis and Diagnosis of the Current Situation in Vjosa River. February 2015

5) Për më shumë referoju aktivitetet dhe botimet në website të Ecoalbania; www.ecoalbania.org

Analiza e kontekstit

Shqipëria aktualisht prodhon energji pothuajse në hidroenergji në 100% [99% hidroenergji: 1% foto voltaike (PV); 2022], por e shet pjesën më të madhe të saj jashtë vendit, e më pas blen lëndë djegëse fosile të cilën e shet me çmim të lartë te konsumatorët gjatë orëve të pikut. Prodhimi i hidroenergjisë zvogëlohet në vitet e thata ose stinët me pak reshje, kështu që energjia vjetore që mund të prodhohet Shqipëria është e luhatshme dhe e paparashikueshme. Konkretisht, në 2020 ishte 5.3 TWh; në 2021 ishte 8.9 TWh dhe në 2022 ishte 7 TWh. Mesatarisht kërkesa për konsum është 7.5 – 8 TWh dhe vendi zakonisht ka një hendek minimal prej 30% të energjisë ndër vite.⁶

Në këtë panoramë energjetike të vendit, dhe në dritën e shpalljes së lumit Vjosa si Park Kombëtar – potenciali hidroenergjetik i basenit do të kërkohet të zëvendësohet me alternativa të tjera energjetike të rinovueshme (Solare, Eolike, Gjeoenergjisë), për të plotësuar boshllëkun e krijuar qoftë strategjik në rang vendi qoftë operacional (kërkesës për energji më afër konsumit) vetëm në basenin e Vjosës. Por edhe për të kontribuar në një furnizim të stabilizuar, më të sigurt me energji, me më pak kosto. Aktualisht qeveria Shqiptare ka tre projekte në këtë zonë me qëllimin për të mbështetur boshllëkun dhe krizën energjitike, si vijon:

- 1** TEC me naftë prej 97 MW, me vlerë 112 milionë dollarë në veri të Vlorës që në 2005. Projekti u mbështet nga një kredi prej 74.5 milionë dollarësh (Pjesa tjetër investim i KESH) por edhe sot nuk funksionon dhe planet për kalimin e tij në TEC me gaz natyror nuk kanë funksionuar akoma.
- 2** Përsa i perket licensave për eksplorim (blloku 4), të dhëna më parë nga shteti Shqipëtar, në zonat përreth luginës së Vjosës, mbetet ende për tu parë potenciali real hidrokarbur që gjendet dhe ndikimi që këto projekte kanë mbi turizmin dhe mjedisin në tërësi në zonë.⁷
- 3** TEC-et lundruese të ankoruara në Vlorë. Kontrata midis KESH dhe Excelerate Energy është një tjetër projekt i qeverisë për të përballuar emergjencën energjitike.

Sipas Agjencisë Ndërkombëtare për Energjitikë e Rinovueshme (IRENA 2021), potenciali i PV diellore për Shqipërinë vlerësohet në 2 378 MW, me prodhim prej 3 706 GWh në vit. (IRENA, 2017a). Studimi i IRENA-s propozon në skenarin e tij një kapacitet të instaluar të PV diellore prej 1 074 MW deri në vitin 2030, me potencial gjenerimi vjetor prej 1 697 GWh. Figura 1 tregon zonat e përshtatshme për zhvillimin e PV diellore dhe nxjerr në pah zonat me potencialin më të lartë për zhvillim që më së shumti ndodhen në pjesën e sipërme të grykëderdhjes së Vjosës (Fier, Karavasta, Spitallë, etj).

6) E. Qëndro (2021). Kontributi i hec-eve në sigurinë energjetike në Shqipëri, situata aktuale dhe sfidat për të ardhmen. RETRO 15+.

7) **Ndikimi në turizëm.** Turizmi është një kontribues kryesor në ekonominë e gjithë Luginës së Vjosës. Pjesa më e madhe e tërheqjes turistike qëndron në natyrën e saj jashtëzakonisht të bukur. Lumenjtë e egër si Vjosa dhe tributarët, kanione dhe gryka, vargmalet malore, kështjella, historia dhe një vijë bregdetare mahnitëse tërheqin milionë vizitorë çdo vit - një numër që pritet të rritet. Ata gjithashtu besojnë me vendosmëri se kjo mundësi do të shkatërrohet nëse Shell kryen shpime për naftë brenda ose përreth zonës. **Ndikimi mbi Lumin Vjosa.** Blloku 4 përbëhet nga një shumëllojshmëri e gjerë mjedisesh të ndryshme. Këto përfshijnë vargmalet mahnitëse malore të kompletuara me kanione dhe gryka, lumin Vjosë dhe një numër përrenjsh dhe lumenjsh më të vegjël që ushqehen në të, pyje të harlisur, shkurre, kodra rrotulluese dhe fshatra të çuditshëm plot me kulturë, traditë dhe bukuri magjepsëse. Pjesa më e madhe e kësaj pjese të vendit është ende e paprekur nga zhvillimi dhe ruan një cilësi vërtet unike dhe të paprishur që po bëhet gjithnjë e më e rrallë në pjesë të tjera të vendit. Shell ka thënë se nuk do të bëjë shpime në lumin Vjosa, por shpimi rreth tij apo pranë lumenjve dhe përrenjve që futen në të është po aq i rrezikshëm.

Ndërsa, vendi ka një potencial konkurrues të erës deri në 7 400 MW sipas skenarit të kapitalit me kosto të ulët (IRENA, 2017). Studimi i IRENA-s propozon në skenarin e tij një kapacitet të instaluar të erës prej 616 MW deri në vitin 2030, me një potencial gjenerimi vjetor deri në 1 794 GWh (IRENA, 2020a). Figura 2, tregon zonat me potencialin më të lartë për zhvillimin e energjisë eolike në Luginën e Vjosës. Nga kjo analizë del qartë se potenciali i lartë për energjitë e rinovueshme do të zëvendësonte më së miri largimin nga hidroenergjinë. Lugina e Vjosës ka një potencial të lartë për këtë lloj energjie alternative, por mungon një analizë e detajuar apo zonimet përkatëse sesa mund të jetë potenciali i instaluar, ku, dhe sa energji elektrike mund të prodhohet. Ndërtimi/instalimi i burimeve energjitime të rinovueshme pa një planifikim të mirëfilltë, dhe në mënyrë të pakontrolluar mund të përbëjnë një kërcënim për basenin e lumit Vjosë dhe Parkun Kombëtar të Lumit Vjosë.

fig.1




Figura 1

Potenciali solar i Shqipërisë dhe zonat kryesore

Figura 2

Potenciali eolik i Shqipërisë dhe zonat kryesore

fig.2



Zgjidhjet e propozuara

1

Rritja e edukimit energjetik përgjatë luginës së Vjosës. Në përgjithësi, njohuritë energjetike janë të varfra përgjatë gjithë basenit të lumit Vjosa për shumë aktorë. Kjo jo në kontekstin e ekspertizës teknike dhe asaj inxhinierike, por në mungesën e vlerësimit të përgjithshëm dhe të kuptuarit se marrëdhënia njerëzore me energjinë është duke ndryshuar. Diskutimet energjetike vazhdojnë të jenë teknokrate, të përqendruara tek furnizimi dhe prodhimi. Sot kërkohet humanizimi i energjisë dhe roli, angazhimi dhe qartësimi i rolit të “komuniteteve të energjisë”. Qytetarët duhet të njohin më shumë rreth formës së energjisë, efencës, kursimit dhe furnizuesin e tyre. Prandaj roli i shoqërisë civile është thelbësor në krijimin e komunitetve energjetike. Për shembull modeli i suksesshëm i Paneleve Diellore zhvilluar nga EcoAlbania në fshatin Kutë,⁸ Mallakastër ka mundësuar prodhimin e energjisë diellore duke instaluar një sistem të pavarur të prodhimit të energjisë elektrike për të furnizuar me energji elektrike pesë ndërtesat publike dhe ndriçimin e rrugëve të fshatit Kutë.

8) <https://solar-ne-kute.ecoalbania.org/>



Solar ne fshatin Kutë © Foto nga Adrian Guri

2

Hartimi i studimeve të thelluara për zonat e energjive të rinovueshme në luginë. Nëse aspektet e hidroenergjisë janë analizuar në detaje, në vend mungojnë analiza dhe zonimi i potencialit ekonomik për burimet diellore dhe të erës në zonë. Kjo pengon zhvillimin e politikave në përcaktimin e objektivave të arritshme, dhe planifikimin e sistemit të energjisë me kosto më të ulët në zonë.

3

Zhvillimi i dëgjësave reale publike, me banorët e zonës, autoritetet lokale dhe Këshillave të Baseneve Ujorë. Autoritetet lokale duhet të zbatojnë kuadrin ligjor (përfshirë parimet e Konventës së Aarhusit) që mandaton dëgjesat publike për projekte ose vendime të rëndësishme që prekin komunitetet lokale. Ata gjithashtu duhet të përdorin kanale zyrtare për të shpërndarë informacion në lidhje me këto dëgjesa, duke u siguruar që vendet e zhvillimit të tyre të jenë të aksesueshme nga të gjithë. Gjithashtu, Këshilli i Basenit të Lumit Vjosa mund të kontribuojë duke shkëmbyer informacion mbi projektet në basenin Ujor Vjosë dhe duke qënë ndërmjetës midis autoriteteve vendore dhe komunitetit. Ata mund dhe duhet të ofrojnë mbështetje me ekspertë gjatë seancave dëgjimore dhe të mbajnë shënime të diskutimeve në mënyrë transparente.

4

Rritja e ndërgjegjësimit mbi efikasitetin energjistik midis komuniteteve lokale për të promovuar praktika të qëndrueshme dhe reduktuar konsumin e energjisë. Pavarësisht se ky opsion tingëllon si zgjidhja më e thjeshtë, në praktikë kërkon shumë kohë dhe burime. Për të rritur ndërgjegjësimin për efikasitetin e energjisë në komunitetet lokale, duhet të fillohet me organizimin e seminareve edukative, partneritetin me organizatat lokale dhe krijimin e materialeve informuese. Një instrument tjetër do të ishte ofrimi i auditimeve pilot të energjisë për qëllime demonstrative dhe organizimi i eventeve në komunitet, për të angazhuar shkollat dhe grupet e të rinjve. Për të inkurajuar përfshirjen dhe programet nxitëse, është e rëndësishme të përfshihen mediat lokale për një mbulim sa më të gjerë. Modele projektesh dhe të ftuar special mund të ndihmojnë dhe shtojnë besueshmërinë në këto përpjekje.



Menaxhimi i burimeve natyrore

Ekspert: Prof.Dr. Etleva Muça

Përshkrim i përgjithshëm

Burimet natyrore janë të lidhura me suportin dhe mirëmbajtjen e cilësisë së tokës, ajrit, ujit dhe biodiversitetit (Pessoa & Silva 2009). Vlerësimi dhe analizimi i burimeve natyrore në lumin Vjosa merr një rëndësi të veçantë jo vetëm për shkak të vlerave mjedisore të zonës por edhe zhvillimit social dhe ekonomik të popullsisë që jeton atje. Vjosa konsiderohet si një nga lumenjtë e fundit të egër në Europë (Frank 2018; Pessenlehner et al 2022) dhe përshkon 13 nga 61 bashkitë e Shqipërisë (Kolonjë, Përmet, Këlcyrë, Dropull, Libohovë, Gjirokastër, Tepelenë, Memaliaj, Mallakastër, Himarë, Selenicë, Fier dhe Vlorë). Lumi shërben si habitat i mbi 1,100 specieve, nga të cilat 13 janë në rrezik zhdukje në rang global (MTM 2022).

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.155 të datës 13 mars 2023 Lumi Vjosa së bashku me tributarët e tij Drino, Shushica dhe Bënça, u shpall Park Kombëtar, kategoria e II sipas IUCN me një sipërfaqe prej 12,727 ha. Ekosistemet pyjore, të ujërave të ëmbla dhe tokave bujqësore luajnë rol dominues në peizazhin e luginës së Vjosës (Schiemer et al. 2020). Ky basen përveç sipërfaqes ujore dhe bregut të lumit prej 11,822 ha, përmban sipërfaqe pyjore prej 99,835 ha, sipërfaqe kullimore prej 17,542 ha, toke bujqësore rreth 32,418 ha, si dhe toka të mbjella me pemë frutore e vreshta me një sipërfaqe e cila mendohet të jetë rreth 22,296 ha. Në pjesën e sipërme dhe të mesme të basenit, bujqësia dhe blegtoria karakterizohen kryesisht nga modele ekstensive për shkak të sipërfaqeve të vogla dhe fragmentizimit të lartë të fermave bujqësore.

Sipas INSTAT (2022) numri i krerëve në pjesën e sipërme dhe të mesme të basenit ka një tendencë rënie krahasuar me vitet e mëparshme, me rreth 28 mijë lope, 596 mijë dhi dhe dele dhe 388 mijë shpendë. Pavarësisht rënies së blegtorisë gjatë vitit të fundit, masa pyjore është zvogëluar me 9% në 20 vitet e fundit nga viti 2000-2023 (Leiter&Toromani 2022) për shkak të zjarreve dhe prerjeve.



Modeli i shfrytëzimit intensiv si në bujqësi edhe në blegtori është praktikuar kryesisht në pjesën e poshtme të basenit të Vjosës dhe rrjedhimisht ka krijuar të ardhura ekonomike më të larta për fermerët krahasuar me të ardhurat nga zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë në rrjedhën e sipërme dhe të mesme. Bujqësia në këtë pjesë është e fokusuar në kultivimin e perimeve në fushë dhe me sera diellore si dhe pemë frutore me rendimente të larta. Edhe pse trofta e rritur artificialisht ofrohet në zona të ndryshme turistike përgjatë këtij pellgu, Ministria e Bujqësisë nuk e ka konfirmuar këtë aktivitet në rajon. Duke qenë se ajo mund të kapet vetëm me grep dhe nuk ka të dhëna zyrtare për kultivimin e saj, peshkimi në këtë zonë ka të gjitha karakteristikat e një sporti aventure.

Lugina e Vjosës gjithashtu është e pasur me burime natyrore të lëndëve minerale si gaz natyror, naftë, bitum dhe qymyrguri. Më saktësisht këto minerale natyrore gjenden në zonën e Drashovicës, Gorisht-Koculit dhe Cakran-Mollaj, në formën e gazit natyror dhe naftës në thellësinë nga 100-4500 metra (AKBN 2019-2022).

Në rajonin e Selenicës gjenden minerale në formën e bitumit dhe rërës bituminoze. Në bashkinë Memaliaj ato gjenden në formën e qymyrgurit i cili ka një depozitë prej 4.4% të të gjithë rezervës kombëtare (AKBN 2019). Minierat sipërfaqësore për gurin gëlqeror dhe silicë janë prezente në luginën e Vjosës me një sipërfaqe totale prej 9.2 km² (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, shkurt 2023). Sipas Ligjit nr. 11/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, neni nr.67, marrja e lëndëve të para si rëra, zhavorri dhe gurët nga brigjet dhe plazhet e basenit ujqor është e ndaluar në zonat e mbrojtura.

Të dhënat aktuale të monitorimit për cilësinë e burimeve ujore në basenin e Vjosës janë të pamjaftueshme dhe nuk përfaqësojnë të gjithë basenin. Raporti i fundit për gjendjen e mjedisit në 2021, përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit prezanton programin e monitorimit të zbatuar në pesë stacione monitorimi në pellgun e lumit Vjosë¹. Nuk ka instalime që djegin lëndë fosile pasi nuk ka impiante prodhuese ose përpunuese që përdorin këtë teknologji. Edhe rafineria e përpunimit të naftës nuk është me funksionale, pasi është dekomisionuar që në vitin 2019. Në Vlorë gjendet një termocentral për prodhimin e energjisë elektrike, e cila duhet të konsumojë burimet fosile për djegie, por nuk ka funksionuar asnjëherë deri më tani.

Politikat dhe kuadri ligjor

Burimet natyrore në Shqipëri, përfshirë dhe basenin e Vjosës, mbikqyren dhe manaxhohen sipas disa ligjeve paralele, për shkak të karakteristikave specifike të ndarjes në: pyje dhe kullota, tokë bujqësore, ujëra të ëmbla, si dhe depozitat minerale sipërfaqësore dhe nëntokësore. Më saktësisht, kuadri ligjor përkatës është përmbledhur si më poshtë:

- ▶ Ligji nr. 57/2020 "Për Pyjet" dhe Agjencia Kombëtare për Pyjet
- ▶ Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullësor", i ndryshuar

1) Vj1 Lumi i Vjosës; Vj2, Lumi i Vjosës ura e qytetit; Vj3 lumi drino Ura e Leklit Tepelene; vj4 Lumi i Vjosës Ura e Memaliaj; Vj5 Lumi Vjosë Ura e Mifolit Vlorë. Ujërat e këtyre 5 stacioneve të monitoruara janë ujëra të pasura me oksigjen duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë. Raporti i gjendjes në mjedis, 2022.

- ▶ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”
- ▶ Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”
- ▶ Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.65/2021
- ▶ Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, Për Hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar

Gjithashtu politikat dhe menaxhimi i burimeve natyrore janë të orientuara nëpërmjet strategjive sektoriale dhe kombëtare.

Strategjia kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim Evropian (SKZHIE), 2021–2030. SKZHIE 2021–2030 është një platformë kyçe e cila siguron prioritizimin e politikave për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale. Harmonizimi i zbatimit të SKZHIE do të kryhet nëpërmjet arritjeve të Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ), për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit. Në të njëjtën linjë me këtë strategji janë miratuar dhe ato ndër sektoriale si më poshtë:

- ▶ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore sipas vendimit nr. 3, datë 13.12.2017 të Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe VKM nr. 73, datë 7.02.2019.
- ▶ Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe Plani i Veprimit sipas VKM nr. 345, datë 22.05.2019 Vendim nr. 814, datë 31.12.2018 Për Miratimin e Dokumentit të Politikave për Pyjet në Shqipëri, 2019–2030
- ▶ Strategjia për konsolidimin e tokës 2016 – 2030, sipas VKM nr. 700, datë 12.10.2016
- ▶ Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027 sipas VKM nr. 460, datë 29.06.2022

Analiza e kontekstit

Burimet natyrore në basenin e Vjosës kanë qenë dhe vijojnë të jenë burimi kryesor i të të ardhurave për banorët lokal. Mënyra si këto burime përdoren është e lidhur ngushtë me traditën dhe nivelin teknologjik të investuar në to. Modelet e ndryshme të shfrytëzimit të bujqësisë kanë sjellë efekte negative në ekosistem ndër vite, si zvogëlimin e sipërfaqeve pyjore, kullotja pa kriter dhe djegie (djegia e fondit pyjor dhe kullosor për rigjenerimin e kullotave të reja), ndotja e tokës dhe e ujërave nga plehurat kimike dhe pesticidet (Sovinc. 2021). Rezultati ka qënë një reduktim i biomases dhe shkatërrimit të biodiversitetit bujqësor si pasojë e shfrytëzimit jo të qëndrueshëm të tokës, shpesh e përdorur për konsum personal apo kullotje pa kriter në natyrë (kosto më e ulët për ushqimin e blegtorisë).

Sfidat për tokën bujqësore, kullosore dhe pyjet janë të lidhura me:

- ▶ Prodhime të kufizuara bujqësore e blegtoriale. Këto vijnë si pasojë e ekzistencës së fermave të vogla me nivel të lartë fragmentizimi dhe rendimente të ulëta.
- ▶ Shfrytëzimi i vazhdueshëm i tokave bujqësore, i cili ka ndërprerë vegjetacionin natyror të bimësisë (Leiter&Toromani 2022).

- ▶ Humbje e tokave për shkak të erozionit dhe mungesës së mbulesës bimore veçanërisht përgjatë brigjeve të lumenjve.
- ▶ Humbje e biomasës për shkak të kullotjes së blegtorisë, prerjeve pa kriter dhe djegies me zjarr të qëllimshëm. Mungesë e edukimit mjedisor mbi politikat e qëndrueshme strategjike të burimeve natyrore.
- ▶ Ndotja e ujërave nga trajtimet bujqësore me plehra kimike dhe pesticide, të cilat do të sjellin pasoja të pariparueshme nëse nuk trajtohen në kohë dhe me profesionalizëm.
- ▶ Mungesa e planeve të përditësuara të mbarështimit për ekonomitë pyjore dhe kullimore ku menaxherët e fondit pyjor planifikojnë kapacitetet mbajtëse dhe përcaktojnë masën e shfrytëzimit si për kullotje, kultivimin e bimëve mjekësore aromatike, turizëm, shfrytëzimin e lëndëve dytësore etj.
- ▶ Koordinim i dobët ndërmjet strukturave në nivel qendror dhe vendor për monitorimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave. Ende ka paqartësi në ndarjen e kompetencave, veçanërisht në lidhje me monitorimin. Delegimi i funksioneve nuk është paraprirë nga një analizë e mirëfilltë dhe mungon financimi i duhur për zbatimin e detyrave funksionale si menaxhimi i pyjeve, bujqësia dhe mbrojtja nga zjarri. (MTM 2020)

Nxjerrja e mineraleve bëhet shpesh shkak për ndotjen mjedisore në zonat në afërsi për shkak të gazrave të cilat në disa raste emëtohen nga djegia, apo për shkak të derdhjeve të mbetjeve dhe shkarkimeve në trupat ujore përreth. Rreziku për ndotjen e ujërave në rrjedhën e mesme të lumit Vjosa është i lartë për shkak të shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane përgjatë lumit, ndërkohë që rrjedha e poshtme kërcënohet nga aktiviteti i shfrytëzimit mineral në zonën e Selenicës (Sovinc 2021). Aktivitetet minerare që përfshijnë gurë gëlqerorë dhe silicë rezultojnë në ndotjen e ujit për shkak të mbetjeve të ngurta. Megjithatë, ndikimi më i rëndësishëm është dëmi fizik i pakthyeshëm i shkaktuar në mjedis gjatë procesit të nxjerrjes, si dhe shqetësimi i jetës së egër për shkak të zhurmave dhe pluhrave.

Sfidat për sa i përket burimeve minerale dhe shfrytëzimit të tyre:

- ▶ Ruajtja e peizazhit natyror. Është fakt që procesi i nxjerrjes së mineraleve shoqërohet me dëmtime të peizazhit dhe bimësisë që mbulon sipërfaqen e tokës në atë rajon.
- ▶ Reduktim i ndotjes së ujit si pasojë e nxjerrjes së mineraleve.

Zgjidhjet e propozuara

Zbutja e ndikimeve të dëmshme në tokë, ujë, biodiversitetit, apo burime natyrore duhet adresuar jo vetëm nga ata që punojnë apo jetojnë në luginën e Vjosës, por edhe nga grupet e interesit në afërsi të saj.

1 Hartimi i planit të menaxhimit të basenit ujor Vjosë nëpërmjet një qasje shumë-sektorale, që promovon përdorimin e balancuar të burimeve ujore si në sektorin e bujqësisë ashtu edhe në industrinë hidrokarbure.

2 Kufizimi i aktiviteteve minerare në basen kërkon një vlerësim gjithëpërfshirës dhe kritik të liçencave ekzistuese dhe ndikimeve të tyre në sistemin lumor. Ky vlerësim duhet të marrë parasysh faktorë të ndryshëm mjedisor, social dhe ekonomik për të siguruar një vendimmarrje të informuar.

3

Orientimi i bujqësisë drejt një modeli bujqësor shumë-funksional i cili ndikon pozitivisht në mirëmenaxhimin e hapsirës rurale, ruajtjen e mjedisit dhe identitetit rural, si dhe në rritjen e punësimit në zonë. Në këtë mënyrë promovohet bujqësia e integruar duke minimizuar dëmet në mjedis.

4

Krijimi i kushteve të favorshme për bazën ushqimore të bagetive duke krijuar sisteme foragjere, me qëllim eliminimin e kullotjes pa kriter të bagëtive në pyje.

5

Mbështetja e fermerëve me forma alternative për sigurimin e energjisë, duke shmangur prerjen jashtë kriteve të drurëve të zjarrit.

6

Krijimi i nismave të edukimit mjedisor në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM-të) brenda Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit. (p.sh. krijimi dhe zbatimi i programit Junior Ranger).

7

Nxitja e komuniteteve lokale me qëllim krijimin e një Grupi Vendor të Veprimit (GVV) si zgjidhje afatgjatë drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

8

Zhvillimi i planeve të përbashkëta për mbarështimin e pyjeve dhe kullotave me koordinim të institucioneve në nivel lokal dhe qendror. Zbatimi i veprimeve që mbrojnë mjedisin dhe promovojnë rigjenerimin e biomassës së humbur nga praktikat e paqëndrueshme të menaxhimit të fondit pyjor.

9

Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale dhe ligjzbatuese në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

10

Rritja e kapaciteteve të nevojshme të fermerëve dhe blegtorëve me qëllim informimin e tyre mbi praktikat e qëndrueshme të zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë përmes bashkëpunimit me shërbimin ekstensiv pranë drejtorive rajonale të bujqësisë.

Referenca

AKBN (2019). Të dhëna statistikore. <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/PETROLEUM-EXPLORATION-AND-PRODUCTION.pdf>;

AKBN (2022). Të dhëna statistikore. <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Mineral-Resources-2022.pdf>;

Frank, T. (2018). Overview of the terrestrial animals of the Vjosa River, Albania: Invertebrates, amphibians, reptiles and the European otter. *Acta ZooBot Austria*, 155, 187–190

INSTAT (2023). Databaza e të dhënave të Institutit të Statistikës. www.instat.gov.al

Leiter M., Toromani E., (2022). *The Forest in the Vjosa River basin: an assessment of the situation.*

Ministry of Tourism and Environment (MTE). (2022). *Vjosa Wild River National Park Vision, Road Map and Feasibility Study December 2022.*

Pessenlehner, S., Liedermann, M., Holzapfel, P., Skrame, K., Habersack, H., & Hauer, C. (2022).


Evaluation of hydropeëer projects in Balkan Rivers based on direct sediment transport measurements; challenges, limits and possible data interpretation – Case study Vjosa River/Albania. River Research and Applications, 38(6), 1014– 1030. <https://doi.org/10.1002/rra.3979>.

Pessoa, A.; Silva, M.R. *Environment based innovation: Policy questions. Finisterra* 2009, 44, 2281–4574.

Schiemer, F., Beqiraj, S., Drescher, A., Graf, È., Egger, G., Essl, F., Vitecek, S. (2020). *The Vjosa River corridor. A model of natural hydro-morphodynamics and a hotspot of highly threatened ecosystems of European significance. Landscape Ecology*, 35(4), 953– 968. <https://doi.org/10.1007/s10980-020-00993-y>

Sovinc A. (2021). *Studimi për mbrojtjen e Luginës së Lumit Vjosa në bazë të standardeve të IUCN-së për zonat e mbrojtura, Beograd, Serbi. IUCN. Iv fq. 40 .*





Zonat e mbrojtura

Ekspert: Prof.As. Elena Kokthi

Përshkrim i përgjithshëm

Zonat e Mbrojtura (ZM) përfaqësojnë një mekanizëm të rëndësishëm mbrojtës për ruajtjen e natyrës, ekosistemeve tokësore dhe ujore si dhe për të parandaluar humbjen e biodiversitetit (Relano et al., 2022). Ky mekanizëm mbrojtjeje legjitimohet edhe për Shqipërinë duke pasur parasysh se vendi përmban rreth 32% të diversitetit llojor të florës së Evropës (IUCN). Në rrjetin kombëtar të ZM-ve në Shqipëri të raportuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Parqet Kombëtare (Kategoria II) zënë rreth 45% të sipërfaqeve totale të ZM, Parqet natyrore (Kategoria IV) 27.6% dhe Peizazhet e mbrojtura (Kategoria V) rreth 21%. Ndërkohë, Kategoria I, III dhe VI së bashku përbëjnë rreth 5% të sipërfaqjes totale të ZM-ve.

Më 15 mars 2023 u krijua Parku Kombëtar i Lumit të Egër Vjosa, i cili aktualisht përfshin lumin Vjosa dhe tre degë të tij. Klasifikimi i Parkut Kombëtar në kategorinë II të IUCN nënkupton mbrojtje sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, si dhe menaxhim strategjik të sfidave me të cilat përballlet ky ekosistem ujor, si ndotja e ujit dhe tokës, menaxhimi i mbetjeve dhe shpyllëzimi.

Parku Kombëtar i Lumit Vjosa bashkëjeton me një sërë ZM të tjera të cilat gjenden në basenin Ujor Vjosë, të detajuara në Tabelën 1. Një paraqitje hartografike e këtyre zonave në Figurën 1 tregon potencialin për zhvillimin e një rrjeti të përbashkët të zonave të mbrojtura dhe ofron mundësi për zhvillim lokal nëpërmjet praktikave të qëndrueshme turistike.

Politikat dhe kuadri ligjor

Historia e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri daton rreth 50 vjet më parë, por që nga vitet 1990 janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe instrumenteve në fushën e mbrojtjes dhe konservimit natyror. Shqipëria në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian është e detyruar të mbrojë dhe mirë-menaxhojë ekosistemet natyrore në bazë të rregullave dhe direktivave të Bashkimit Evropian. Ligji nr 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” është ligji kuadër i cili përfaqëson njehsimin në masë të gjerë të legjislacionit kombëtar për ruajtjen e biodiversitetit me atë të BE-së. Në këtë ligj i kushtohet një seksion i veçantë (përkatësisht seksioni V) zonave të mbrojtura me interes ndërkombëtar dhe në veçanti zonave Natura 2000. Gjithashtu, VKM Nr. 1156, datë 24.12.2020 përbën një hap shumë të rëndësishëm drejt gjenerimit të të ardhurave nga shërbimet dhe aktivitetet ekoturistike në ZM dhe pavarësisht financiare. Në vend është krijuar dhe Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura, i cili përfshin një numër prej 800 zonash të tilla (përfshirë këtu edhe monumentet e natyrës), të cilat zënë një sipërfaqe prej rreth 21% të territorit të vendit.



© Foto nga Rajmond Kola

Analiza e kontekstit

Zbatimi i ligjit nr. 81/2017 për “Zonat e mbrojtura” parashikon strukturat përkatëse administrative¹, me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) si institucionin publik qëndror në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTE), që drejton dhe menaxhon mbrojtjen dhe aktivitetet menaxhuese të të gjitha zonave të mbrojtura natyrore. Ky ligj përcakton Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM-të) si organet kompetente në nivel qarku, në varësi të AKZM (AdZM Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë janë përgjegjëse për Basenin e Vjosës) që mbulojnë menaxhimin dhe aspektet e monitorimit. Bashkitë të cilat kanë në territorin e tyre administrativ zona të mbrojtura, bashkëpunojnë me AdZM-të respektive. Ligji gjithashtu parashikon krijimin e komiteteve menaxhuese të zonave të mbrojtura me funksion mbikqyrës për zbatimin e planeve të menaxhimit. Në përbërje të tyre këto komitete përfaqësohen nga bashkia/bashkitë, brenda territorit administrativ të të cilit/cilave ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, dhe palë të interesuara në nivel lokal që kanë lidhje direkte me bujqësinë, turizmin, pyje-kullota, shoqërisë civile, bizneset etj.

Aktualisht, nuk ka një strategji për zonat e mbrojtura që do të lejonte bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Në përgjithësi, funksionimi i AdZM-ve shpesh përballlet me sfida për shkak të burimeve të kufizuara, si në aspektin e burimeve njerëzore, të cilat zakonisht janë të pamjaftueshme për të mbuluar territorin në përgjegjësi, ashtu edhe në aspektin e kapaciteteve financiare për të kryer profesionalisht të gjitha detyrat e menaxhimit dhe monitorimit. Edhe pse sipas ligjit Nr.81/2017, menaxhimi i zonave të mbrojtura duhet të bëhet në përputhje me Planin Specifik për Zonat e Mbrojtura dhe Planin për Administrimin e Rrjetit Ekologjik të vendit, ende nuk ka një studim të mirëfilltë për këtë. Në përgjithësi, zonat e mbrojtura në basenin e Vjosës nuk kanë një plan të përditësuar menaxhimi të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Zgjidhjet e propozuara

- 1 Rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve teknike dhe logjistike për stafin e AKZM/AdZM-ve në mënyrë që të përditësohen vazhdimisht mbi aspekte të ndryshme të punës lidhur me planifikimin, menaxhimin, promovimin apo monitorimin në terren.
- 2 Hartimin e planeve të menaxhimit të ZM-ve në rastet kur nuk ka një të tillë dhe përditësimi i atyre ekzistuese. Në këtë pikë është me rëndësi koordinimi i institucioneve dhe harmonizimi i përpjekjeve për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Basenin e Vjosës me hartimin e planit të menaxhimit të burimeve ujore të Basenit ujqor Vjosë, i cili është në proces.
- 3 Promovimi i turizmit të qëndrueshëm, ekoturizmit, agroturizmit etj., në përputhje me standartet e IUCN për zonat e mbrojtura dhe sipas kategorive specifike, si një mundësi për të përmirësuar të ardhurat në zonat e mbrojtura.

1) Kreu IV Strukturat e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

4

Të ardhurat të cilat gjenerohen brenda zonave të mbrojtura duhet ti rikthehen zonës së mbrojtur nëpërmjet investimeve në funksion të menaxhimit, monitorimit dhe promovimit të tyre si dhe të ndihmojnë në mirëqenien e komunitetit në afërsi të ZM-ve.

5

Nxitja e aktiviteteve edukuese dhe sensibilizuese mbi rëndësinë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Basenin Ujor Vjosë, si një mjet për të siguruar ruajtjen afatgjatë të ekosistemeve natyrore që mundësojnë njëkohësisht mirëqenie për komunitetin.

6

Draftimi i një udhërrëfyese për fuqizimin, informimin, trajnimin e aktorëve si dhe nxitja e bashkëpunimit mes tyre, për të mundësuar një menaxhim të qëndrueshëm të ZM-ve njëkohësisht dhe të komuniteteve lokale.

7

Dizenjimi i një propozimi unik shitje (Unique Sellig Proposition) që përfaqon në të njëjtën kohë principet e zhvillimit ekoturistik dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm pa dëmtuar integritetin ekologjik të Basenit të Vjosës.

8

Promovimi i një qasje të menaxhimit të integruar duke marrë në konsideratë shërbimet e ndryshme të ekosistemit në Basenin e Vjosës duke krijuar një impakt pozitiv ekonomik-social-mjedisor në komunitetet lokale.

Figura 1. Zonat e mbrojtura në Basenin Ujor Vjosë

Legjenda

 Baseni Ujor Vjosë

Zona e mbrojtur


Kategoria

 Park Kombëtar Detar

 Park Kombëtar

 Park Natyror

 Pejshazh i mbrojtur



Figurë 1: Harta e ZM-ve në Basenin e Vjosës sipas klasifikimeve të IUCN. Burimi: Përpunuar me të dhënat e fundit të ZM, Maj 2023

These maps are produced under ESPID4VJOSA project, implemented by Euronatur and EcoAlbania and financed by Austrian Development Agency

 Austrian Development Agency

 EURONATUR

 EcoAlbania

Tabela 1. Zonat e mbrojtura të cilat ndodhen në Basenin Ujor Vjosë

Zona e mbrojtur	Sipërfaqe (ha)	Kategoria (sipas IUCN)
Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës – Dangëlli”	36003,76	II
Parku Natyror “Gërmenj”	1410	IV
Parku Natyror “Bredhi i Kardhiqit-Rzëzomë”	4303,6	IV
Peizazhi i Mbrojtur “Pishë Poro-Nartë”	16124,61	II
Parku Kombëtar “Karaburun-Sazan”	12437,7	II
Parku Kombëtar “Llogora”	1769,2	II
Parku Kombëtar “Butrint”	8622,2	IV
Parku Natyror “Bredhi i Zhulatit”	936,2	IV
Parku Natyror “Syri i Kaltër”	293,3	IV
Parku Natyror “Bredhi i Sotirës”	4927,67	IV
Parku Natyror “Zagori”	24607,63	IV
Parku Natyror “Porto Palermo”	1694,98	IV





Ekoturizmi

Ekspert: Dr. Klodian Muço

Sipas një analize të Bankës Botërore të vitit 2023, "Shqipëria njihet si një destinacion plazhi për turistët që zakonisht preferojnë qëndrime më të shkurtra me shpenzime individuale të ulëta – një profil i cili lidhet me një zinxhir vlerash turistike të padiversifikuar dhe me një gamë të kufizuar atraksionesh dhe aktiviteteve"¹. Lugina e Vjosës, dhe në veçanti Parku Kombëtar i Lumit Vjosa, ka potencialin t'i sigurojë Shqipërisë një destinacion që është i ndryshëm nga turizmi i detit dhe rërës që mbizotëron aktualisht.

Qëndrueshmëria është në qendër të vizionit për Parkun Kombëtar të Lumit Vjosa dhe luginën në të cilën ai rrjedh. Kjo përfshin mbrojtjen e ekosistemeve kryesore të lumit dhe mjedisin e lidhur me të, përfshirjen e komuniteteve të lidhura me lumin për të siguruar që ata janë pjesë e procesit të zhvillimit të zonës dhe gjithashtu rritjen e përfitimeve ekonomike për komunitetet lokale nga zhvillimi i ekoturizmit në luginë duke përmirësuar edhe sistemet ekologjike të zonës.

1) Turizmi 2.0 në Shqipëri: Një mundësi e re për rritje elastike – Perspektiva Evropiane shkurt 2023



© Foto nga Katja Pokorn

Përshkrim i përgjithshëm

Vjosa konsiderohet si një nga lumenjtë e fundit të egër në Europë, ku degët e tij rrjedhin lirshëm nga malet e Pindit në Greqi deri në bregdetin Adriatik në Shqipëri. Së bashku me degët e tij ai formon një ekosistem lumor mbi 270 kilometra të gjatë i karakterizuar nga një nivel biodiversitetit me rëndësi kombëtare dhe globale.

Turizmi në luginën e Vjosës është rritur në mënyrë të qëndrueshme, veçanërisht vitet e fundit, ku shumë vizitorë të apasionuar pas bukurive natyrore dhe natyrës së egër kanë filluar të ndjekin një sërë aktivitetesh në zonë, nga ecja deri te rafting, me qëllim shijimin e bukurive natyrore të lumit dhe vlerave kulturore të luginës.

Turizmi në Përmet

Përmeti, qyteti i dytë më i madh në qarkun e Gjirokastrës, ku rrjedh lumi Vjosa, po bëhet gjithnjë e më i vizituar, veçanërisht nga turistët që preferojnë aktivitete në natyrë. Nëse vizitorët që vizitonin Përmetin qëndronin në Gjirokastrë ose ndalonin rrugës për në Korçë, sot gjithnjë e më shumë turistë përdorin Përmetin për të ndaluar. Një ndër arsyet për këtë është se në dekadën e fundit operatorët turistikë lokal nga Përmeti kanë zhvilluar oferta turistike rreth aktiviteteve në natyrë, duke e bërë qytetin dhe rrethinat e tij një destinacion për rafting, ecje dhe çiklizëm, si dhe për eksperiencë kulinare. Si rezultat, turizmi në Përmet po rritet, edhe pse është ende në fazat e tij të para: pjesa më e madhe e turizmit në Përmet dhe në të gjithë rajonin rrotullohet rreth lumit Vjosa.

Politikat dhe kuadri ligjor

Baza ligjore në Shqipëri është Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar. Ndërsa në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Republika e Shqipërisë ka aprovuar një Strategji sektoriale të emërtuar “Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (SKZHQT) 2019 – 2023”.

Strategjia në fjalë, garanton bazën për Planet e Veprimit për zhvillimin e ekoturizmit dhe agroturizmit, ku edhe për këtë të fundit ka një bazë ligjore e cila është VKM nr. 22 datë 12.01.2018. Kjo Strategji përmban “miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/ objekteve në funksion të tij”. Planet e Veprimit që përmban strategjia në fjalë përbëjnë bazën metodike dhe administrative për zhvillimin e agroturizmit si një nga format më të mundshme drejt turizmit të qëndrueshëm. Kjo edhe për shkak të mundësisë së përfshirjes së drejtpërdrejtë të fermerëve në këtë lloj aktiviteti, çka garanton rritjen kapilare të të ardhurave duke i mbajtur komunitetet të lidhura me territorin.

Në SKZHQT-në, zona e “Vjosë – Zagori”, përkatësisht nga Gryka e Këlcyrës deri në kufirin me Greqinë, me sipërfaqe 441 km², identifikohet si “zonë me përparësi zhvillimin e turizmit”. Nën vizionin “Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”, në Strategji identifikohen tri grupe të llojeve të turizmit, përkatësisht “bregdetar”, “natyror”, dhe “tematik”. “Ekoturizmi” konsiderohet si një nga tre llojet e turizmit të nënsektorit “natyror”. Si një nga objektivat specifike të Strategjisë njihet “Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është autoriteti publik përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e politikave në fushën e turizmit në Shqipëri. Organe të tjera përgjegjëse në fushën e turizmit, të lidhura me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, janë:

- ▶ Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit
- ▶ Agjencia Kombëtare e Turizmit
- ▶ Agjencia Kombëtare e Bregdetit
- ▶ Njësitë e qeverisjes lokale (bashkitë)
- ▶ Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike.

Së fundmi, lumi Vjosa është shpallur Park Kombëtar, gjë e cila do të rrisë më tej potencialin ekoturistik të zonës për zhvillimin e aktiviteteve në natyrë si rafting, çiklizmi malor, alpinizëm, ecje në natyrë, shëtitja me kuaj, ture studimore, etj. Në këtë kuadër, e gjithë lugina e Lumit Vjosa dhe basenit të saj ujëmbledhës, për shkak të vlerave të larta mjedisore, përmbush plotësisht kushtet e përcaktuara në Strategjinë për nxitjen dhe zhvillimin e turizmit në nënsektorin natyror.

Analiza e kontekstit

Shfytëzimi i burimeve natyrore për arsye turistike po njih një zhvillim të shpejtë përgjatë luginës së Vjosës. Aktualisht, llojet më të ushtruara të ekoturizmit në këtë luginë janë: rafting, hiking, kanotazh, alpinizëm, turizëm termal, vëzhgimi i shpendëve, etj. Kushtet klimatike tipike mesdhetare në luginën e Vjosës, me dimër me rreshje e të butë, dhe verë të nxehtë e të thatë, favorizojnë diversifikim të aktiviteteve turistike me bazë natyrën gjatë gjithë vitit. Kjo ka nxjerrë në pah nevojën për promovimin e territorit dhe vlerave të tij, duke përfshirë vlerat natyrore, vlerat e trashëgimisë kulturore, dhe aspekte të tjera të lidhura me turizmin kulinar si eno-gastronomia, etj.

Këto aktivitete do të fokusohen në lumin Vjosë dhe degët me rrjedhje të lirë, tashmë pjesë e Parkut Kombëtar. Gjithashtu këto aktivitete do të shtrihen nga lumi deri në buzë të luginës, ku dhe janë krijuar bashkime vullnetare të subjekteve të cilat operojnë në fushën e turizmit, agro-ushqimit, agroturizmit, artizanatit, etj. Shoqata më e strukturuar e këtij lloji është “Pro Përmet” që vepron në territorin e Bashkisë Përmet. Kjo tendencë e rritjes së këtij lloji biznesi është pozitive për zonën, por ballafaqohet me pengesa dhe sfida si vijon:

Kapacitete të kufizuara.

Megjithëse është rritur kërkesa për aktivitete turistike të klasifikuara si ekoturizëm apo agroturizëm, ka ende mangësi në njohjen e potencialeve natyrore dhe mënyrës së ofrimit të tyre për turizëm të qëndrueshëm.

Edukim mjedisor i dobët i komunitetit.

Tradita e “zhvillimit ekonomik” klasik vë në përpjestim të drejtë “përfitimin ekonomik me dëmet mjedisore”, çka do të thotë se në përgjithësi në ekonominë e tregut të lirë është instaluar bindja se “dëmet mjedisore janë pasojë e pashmangshme e zhvillimit ekonomik”. Ky mentalitet është rreziku kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm edhe në luginën e Vjosës dhe mund të zbrapset vetëm me anë të edukimit mjedisor dhe me anë të nxitjes së aktiviteteve ekonomike të cilat krijojnë përfitim ekonomik pa e dëmtuar mjedisin. Pra në thelb mund të krijohet vlerë e shtuar në ekonomi falë shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe promovimit turistik të tyre pa i dëmtuar ato. Kjo do të gjeneronte zhvillim të qëndrueshëm qoftë për komunitetin lokal aktual qoftë për brezat e ardhshëm falë edhe krijimit të aktiviteteve plotësuese që lidhen me turizmin.

Migrimi rural dhe braktisja rurale.

Një tërësi zonat rurale të Shqipërisë janë të përfshira nga migrimi rural i cili ka në bazë varfërinë rurale. Kjo dukuri është e theksuar në zonën e luginës së Vjosës, për shkak të afërsisë me Greqinë si një pol tërheqës i lëvizjes migratore në 32 vitet e fundit. Migrimi rural përbën rrezik për çdo strategji lokale të zhvillimit, për shkakun e largimit të burimeve njerëzore i cili vë në rrezik qëndrueshmërinë sociale, mjedisore, dhe ekonomike. Kjo dukuri është e nevojshme të frenohet, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet krijimit të mundësive që paraqiten për vetëpunësim në sektorin e ekoturizmit dhe agroturizmit për komunitetin lokal.

Globalizimi i produkteve lokale dhe kulturës lokale.

Një sfidë e veçantë është ruajtja e autenticitetit të produkteve lokale ushqimore, bimore dhe shtazore, çka përbën garancinë kryesore të mbajtjes së flamurit të cilësisë për gastronominë lokale si atraksion thelbësor për ekoturizmin dhe agroturizmin.

Nivel i ulët i bashkëpunimit lokal.

Mungesa aftësisë për krijimin e rrjeteve të aktorëve të ekoturizmit dhe agroturizmit është pengesë për zhvillimin e këtyre aktiviteteve dhe për qëndrueshmërinë ekonomike, sociale, dhe mjedisore të zonës.

Mungesa e promovimit të ekoturizmit.

Mungesa aftësisë për krijimin e rrjeteve të aktorëve të ekoturizmit dhe agroturizmit është pengesë për zhvillimin e këtyre aktiviteteve dhe për qëndrueshmërinë ekonomike, sociale, dhe mjedisore të zonës.



Zgjidhjet e propozuara

- 1 Forcimi i ndërgjegjësimit institucional.** Ekoturizmi është shfrytëzimi i natyrës për qëllime turistike pa e prekur atë. Institucionet lokale duhet ti kushtojnë më tepër rëndësi mbajtjes pastër të ambientit të luginës dhe të ndalojnë shfrytëzimin e pikave të inerteve përgjatë basenit të lumit. Gjithashtu nevojitet edhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i infrastrukturës logjistike në funksion të aktiviteteve ekoturistike.
- 2 Brandimi i Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa dhe mbështetje institucionale për çertifikimin e produkteve lokale bio përgjatë luginës së Vjosës.** Pra duke kaluar nga brandimi i produkteve lokale sipas zonave të një brand gjithpërfshirës që promovon gjithë luginën dhe jo vetëm produkte nga lokalitete të caktuara.
- 3 Promovimi i ekoturizmit në luginën e Vjosës në panairët ndërkombëtare që organizon apo merr pjesë vendi ynë.**
- 4 Universiteti i Gjirokastrës** duhet të përfshijë në kurrikulën e tij edhe kurse të dedikuara për ekoturizmin apo turizmin e aventurës.
- 5 Krijimi i ofertave turistike të përbashkëta** që promovojnë ekoturizmin, nga bashkitë që shtrihen në luginën e Vjosës në bashkëpunim me Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore si institucionet që mbulojnë menaxhimin e potencialit natyror dhe kulturor.
- 6 Trajnime dhe ndërgjegjësim** i komunitetit si dhe promovimi i modeleve të organizimit në nivel lokal ndërmjet aktorëve publik dhe atyre privatë mund të konsiderohet një opsion shumë i mirë për promovimin e ekoturizmit si një alternativë zhvillimi për luginën e Vjosës.
- 7 Krijimi i mundësive të vetëpunësimit** duke promovuar ekoturizmin në luginën e Vjosës nga ana e insitucioneve lokale dhe qendrore, përgjegjëse për sektorin e turizmit. Kjo nismë do të sillte një kërkesë më të lartë për guida turistike të çertifikuara dhe për akomodim. Po ashtu do të çonte në rritjen e kërkesës për konsumin e produkteve vendase duke promovuar rëndësinë e sektorit bujqësor.



Ndryshimet klimatike

Ekspert: Prof. Dr. Romeo Hanxhari

Përshkrim i përgjithshëm

Ndryshimet klimatike (dhe humbja e biodiversitetit si rrjedhojë) përfaqësojnë kërcënimin më të madh jo-ushtarak me të cilin është përballur ndonjëherë njerëzimi. Ky kërcënim ka aftësinë që të vërë në pikëpyetje të gjithë sistemet natyrore dhe shoqërore mbi të cilat bazohet ekzistenca e njeriut si specie natyrore dhe si qenie shoqërore. Në zonën e luginës së Vjosës, ndryshimet klimatike vënë në rrezik qëndrueshmërinë ekonomike të komuniteteve lokale, për shkak të uljes së disponueshmërisë së ujit, ekstremizimit të klimës, ndryshimeve në ciklin hidrologjik të ujërave, ndryshimit të mbulesës bimore, rënies së rendimenteve në blegtori dhe në kulturat bujqësore. Konkretisht, rritja e shpeshësisë dhe ashpërsisë së rasteve të thatësirave, vë në rrezik furnizimin me ujë të fermave bujqësore. Po ashtu, rritja e shpeshësisë dhe ashpërsisë së përmytjeve vë në rrezik jetën dhe pasurinë e komuniteteve të gjithë zonës.

Sipas raporteve të OKB-së, rritja e temperaturave mesatare do të afrojë kohën e të korrave dhe të vjeljes, duke ulur cilësinë e produkteve, ndërsa shpeshimi i valëve të të ftohtit do të rrezikojë mbarëvajtjen e kulturave bujqësore. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka në fuqi dy strategji për ndryshimet klimatike: zbutjen dhe përshtatjen. Për "zbutjen" e ndryshimeve klimatike, në vitin 2015 OKB ka aktivizuar Marrëveshjen e Parisit e cila synon ruajtjen e ngritjes së temperaturës mesatare globale në jo më shumë se 2°C në krahasim me periudhën para-industriale, ndërkohë që deri tani temperaturat janë rritur me 1.2°C. Lidhur me frenimin e rritjes së mëtejshme të temperaturës, zbatimi i parimeve të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në tërësi dhe atyre ujore në veçanti në gjithë basenin e Vjosës, si dhe mbajtja e shtratit të lumit të Vjosës në gjendje natyrore, kontribuojnë pozitivisht.

Paralelisht, OKB ka sugjeruar fortë edhe strategjinë e "përshtatjes" me ndryshimet klimatike, që synon ndryshimin e sistemeve sociale e ekonomike njerëzore, duke i bërë ato sa më elastike ndaj impakteve nga ndryshimet klimatike dhe duke u dëmtuar sa më pak.

Politikat dhe kuadri ligjor

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit, më 22 prill 2016 në Nju Jork. Në vijim, Shqipëria ka dorëzuar pranë OKB-së dokumentin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) me angazhime që reduktojnë emetimet e gazrave serrë deri në vitin 2030 me 11,5% në krahasim me vitin 2011. Në zbatim të këtyre angazhimeve, Shqipëria ka hartuar “Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike & Plani i Veprimit” (SKNK & PV) si dokumentin kryesor strategjik që synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e zbutjes dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

SKNK&PV u hartua në 2018 dhe u aprovua në 2019 në përputhje dhe në mbështetje të legjislacionit të atëhershëm të BE-së, por Komisioni i ri Evropian, nëpërmjet aprovimit të “Marrëveshjes së Gjelbër” (Green Deal) në 11 dhjetor 2019, i ngriti në një nivel cilësisht të ri ambiciet evropiane për mjedisin dhe klimën. Green Deal synon që deri në vitin 2050 Evropa të bëhet kontinenti i parë neutral ndaj klimës, pra me emetime net zero të karbonit. Në 6 tetor 2021, BE transpozoi në Samitin “Bashkimi Evropian & Ballkani Perëndimor” në Sofie “Marrëveshjen e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor”, që përfaqëson po ashtu një shkallë të re të angazhimit kombëtar edhe për Shqipërinë. Baza ligjore e veprimit në këtë kuadër në Republikën e Shqipërisë është Ligji nr. 155, datë 7.12.2020 “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar.

Analiza e kontekstit

Ndryshimet klimatike kanë pasojë komplekse. Nuk bëhet fjalë vetëm për ngritje të temperaturës mesatare globale, por edhe për gjithë zinxhirin e pasojave natyrore dhe sociale e ekonomike të lidhura me të. Deri tani, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), i cili është autoriteti i vetëm shkencor për ndryshimet klimatike në botë, dhe me prestigj të padiskutueshëm, ka botuar gjashtë Raporte zyrtare mbi ndryshimet klimatike në planet. Më i fundit prej tyre, Raporti “AR6”, i bërë publik në vitin 2022 dhe në fillim të vitit 2023 është burimi i vetëm i besueshëm i të dhënave mbi ndryshimet klimatike. Të dhënat e këtij raporti janë specifikisht edhe për kategorinë “ekosistemet tokësore të zonës Mesdhetare”, ku përfshihet edhe lugina e Vjosës në veçanti. Sipas këtij raporti, në zonën e Vjosës evidentohen disa pasoja të mundshme të lidhura me ndryshimet klimatike, si për shembull pasojat në ndryshimin e strukturës së ekosistemeve, në zhvendosjen e specieve drejt veriut apo drejt lartësive, dhe në ndryshimin e fazave fenologjike.

Raporti thekson se ka mundësi të lartë që me ndryshimet klimatike, në zonat e sipërcituara ka ndikime negative në sistemet humane, veçanërisht në rënien e aftësive për prodhime bujqësore për shkak të i) kufizimit të sasisë së ujit; ii) rënies së shëndetit dhe produktivitetit të bagëtive; iii) uljes së produktivitetit të burimeve të peshkimit apo akuakulturës, etj. Dëmtimi i sektorëve kyç ekonomik është me besueshmëri mesatare i lidhur me ndryshimet klimatike. Një rënie e produktivitetit ekonomik të lidhur me blegtorinë dhe bujqësinë, do ta shtynte komunitetin e luginës së Vjosës ose drejt emigrimit ose drejt shtimit të impaktit mbi burimet natyrore të zonës, çka do të përbënte kërcënim afatgjatë për cilësinë e ekosistemeve natyrore të zonës. Kjo e bën emergjent zhvillimin dhe zbatimin e një plani veprimi për përshtatjen me ndryshimet klimatike për aktivitetet ekonomike të komuniteteve.

Përpunimi i të dhënave lokale është bërë edhe nga Banka Botërore ku rezultojnë se Shqipëria është një nga vendet më të cënueshme ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Mesdheut. Ndryshimet e motit janë vërejtur tashmë gjatë 15 viteve të fundit me rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta si përmbytjet dhe thatësitrat. Reshjet e dëborës kanë qenë gjithnjë e më pak dhe ato shkrihen më herët dhe më shpejt se vitet e kaluara. Parashikimet tregojnë një rënie të reshjeve në periudhën e verës me rreth 10 % deri në vitin 2020 dhe 20 % deri në vitin 2050.

Zgjidhjet e propozuara

Qëndrueshmëria e rritjes së mirëqënies së komunitetit të zonës së luginës së Vjosës është parakusht për suksesin e çdo strategjie të mbrojtjes së natyrës dhe burimeve ujore edhe në kushtet e ashpërsimit të pasojave të ndryshimeve klimatike. Përsa i përket përshtatjes me ndryshimet klimatike duhen planifikuar dhe realizuar ndryshime në mënyrën e funksionimit të jetës ekonomike e sociale të komuniteteve të zonës së Vjosës.

1 Edukimi mjedisor për ndryshimet klimatike. Çdo zgjidhje do të fillonte me edukimin mjedisor dhe informimin e komunitetit mbi shkaqet e ndryshimeve të evidentuara në produktivitetin dhe efikasitetin e ekonomive të tyre bujqësore e blegtorale. Ndërgjegjësimi i komunitetit duhet të synojë disa mesazhe: i) problemet e evidentuara janë të lidhura me ndryshime globale, të cilat kanë nevojë jo për zgjidhje globale por për zgjidhje lokale; ii) zgjidhjet janë urgjente, por ato nuk mund të kenë efekte të menjëhershme; iii) zgjidhja nuk është intensifikimi i përdorimit të burimeve natyrore, sepse kjo do të çonte vetëm në përkeqësim të shanseve për sukses; iv) zgjidhja për komunitetin është vetëm përshtatja me kushtet e reja klimatike nëpërmjet ndryshimeve të vogla e të qëndrueshme. Kjo fushatë ndërgjegjësimi do të garantonte bashkëpunimin e komunitetit në mbrojtjen e cilësisë mjedisore të zonës së mbrojtur të Vjosës dhe në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në basenin e Vjosës.

2 Analiza e impakteve të ndryshimeve klimatike. Ndryshimet klimatike veprojnë nëpërmjet rritjes së temperaturave mesatare, rritjes së shpeshtësisë dhe ashpërsimit të reshjeve në formë rrebeshi, periudhave të gjata pa reshje, ekstremizimit të temperaturave, etj. Analiza e pasojave (impakteve) përfshin vlerësimin e rastisjes dhe intensitetit të dukurive si: përmbytjet, thatësitrat, valët e të nxehtit, valët e të ftohtit, etj, si edhe dëmet përkatëse në burimet natyrore dhe ekonomitë lokale.

3 Plani i veprimit të përshtatjes me ndryshimet klimatike. Hartimi i një Plani masash për përshtatjen me ndryshimet klimatike, që do të përfshinte edhe ndryshimin gradual të strukturës ekonomike të komuniteteve, nga një ekonomi e bazuar tërësisht tek sektori primar (bujqësi dhe blegtori), drejt një strukture më elastike që e kombinon sektorin primar me sektorin e shërbimeve, vecanërisht me ekoturizmin dhe agroturizmin, të cilat janë aktivitetet më të përshtatshme në kushtet e uljes së produktivitetit bujqësor për shkak të ndryshimeve klimatike, si edhe në kushtet e reja të shpalljes së shtratit të lumit Vjosa si zonë e mbrojtur.

4 Integrimi i politikave dhe strategjive. Është i domosdoshëm integrimi sa më i plotë i detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor mbi ndryshimet klimatike me politikat sektoriale dhe ndërsektoriale regjionale dhe lokale. Kjo është emergjente për proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes, me qëllimin harmonizimin e përpjekjeve për të zbutur ndryshimet klimatike dhe për të parandaluar pasojat e rënda negative të ndryshimeve klimatike.





www.ecoalbania.org
www.euronatur.org